

VENDIM
Nr.118, datë 2.2.2009

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.83, DATË 3.2.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR RRËSHEN-KALIMASH (PJESA E DYTË)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 3 të vendimit nr.83, datë 3.2.2008 të Këshillit të Ministrave, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Sipërfaqja 162 397 m², tokë/arë, bëhet 161 348 (njëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e treqind e dyzet e tetë) m².

b) Vlerësimi 105 558 050 (njëqind e pesë milionë e pesëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e pesëdhjetë) lekë, për sipërfaqen tokë/arë, bëhet 104 876 200 (njëqind e katër milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind) lekë.

c) Sipërfaqja 10 368 m², tokë/truall, bëhet 11 417 (njëmbëdhjetë mijë e katërqind e shtatëmbëdhjetë) m².

ç) Vlerësimi 15 552 000 (pesëmbëdhjetë milionë e pesëqind e pesëdhjetë e dy mijë) lekë, për sipërfaqen tokë/truall, bëhet 17 125 500 (shtatëmbëdhjetë milionë e njëqind e njëzet e pesë mijë e pesëqind) lekë.

d) Vlera e përgjithshme e shpronësimit, nga 121 110 050 (njëqind e njëzet e një milionë e njëqind e dhjetë mijë e pesëdhjetë) lekë bëhet 122 001 700 (njëqind e njëzet e dy milionë e një mijë e shtatëqind) lekë.

2. Pronarët të kompensohen për diferencën e konvertimit në truall të sipërfaqes së shpronësuar sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Totali i diferencës së konvertimit, prej 891 650 (tetëqind e nëntëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekësh, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave, në Bankën e Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.

4. Likuidimi të fillojë më 30.1.2009 dhe të përfundojë më 30.3.2009.

5. Pronarët e listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmim ZRPP”, të kompensohen për diferencën përkatëse të konvertimit të tokës në truall, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

6. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarëve brenda afateve të përcaktuara në pikën 4 të këtij vendimi, në bazë të dokumentacionit të pronësisë.

7. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE

LISTA E PRONARËVE QË PREKEN NGA KORRIDORI DURRËS-MORINË (SEKSIONI RRËSHEN-KALIMASH)
Lloji i pasurisë së patundshme: tokë truall

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	VKM nr.83,datë 3.2.2008				Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr.pas	Ndryshimi sipas ZRPP-së			Diferenca e llogaritur për likuidim	Shënime
					Nr.pas	Sip.m ² arë	Çmimi m ²	Vlera në lekë						Sip m ² truall	Çmimi m ²	Vlera/ lekë		
	Fshati Mashterkor																	
1	Vasil	Gjok	Ndreca	2610	237	236	650	153400	Vasil	Gjok	Ndreca	2610	237	236	1500	354 000	200 600	Konfirmuar nga ZRPP
2	Anton	Nikoll	Ndreca	2610	236	313	650	203450	Anton	Nikoll	Ndreca	2610	236	313	1500	469 500	266 050	Konfirmuar nga ZRPP
3	Eridon	Fran	Skana	2610	214/1	500	650	325000	Eridon	Fran	Skana	2610	214/1	500	1500	750 000	425 000	Konfirmuar nga ZRPP
		Totali				1049		681850						1049		1573500	891650	

